



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 87-të, të mbajtur më 01.06.2023, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-1287/1 të datës 28.02.2022, me pretendime për keqpërdorim të pozitës dhe detyrës zyrtare me qëllim me qëllim të fshehjes së autorëve të veprave penale, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja përcaktoi se në pajtim me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-1287/1 të datës 28.02.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Me datë 28.02.2022, nga një parashtruesi njohur është bërë denoncim me pretendime për keqpërdorim të pozitës dhe detyrës zyrtare me qëllim të fshehjes së autorëve të krimeve dhe është konstatuar rasti me numër 12-1287/1, datë 28.02.2022.

Në denoncim, parashtruesi kërkon nga KSHPK-ja të përcaktojë nëse ka korrupsion në veprimet e organeve kompetente në lidhje me përplasjen e djalit të tyre të mitur, e ndodhur më 7 mars 2021, në rrugën -----.

Në denoncim thuhet se me atë rast djali i tyre ka qenë në shoqërinë e 4 fëmijëve të tjerë të cilët kanë dalë në piknik dhe asnjë nga institucionet nuk e merr parasysh këtë fakt, pra e fshehin për të mos zbuluar se djali i tyre ka qenë në fakt i vararë.

Në vijim thuhet se dyshime të tilla burojnë nga informacioni se vrasja është organizuar, porositur dhe kryer nga një familje ----- dhe personat zyrtarë kanë shpërdoruar pozitën zyrtare duke lejuar ekzekutorët për të keqinterpretuar se kush e drejtonte ----- e goditur, biçikleta dhe ----- u zhdukën dhe pjesa tjetër e fëmijëve u kërcënuan të mos thonë të vërtetën.

Gjithashtu në denoncim thuhet se lejohet me zhvendosjen e gjurmëve të tregohet se ----- është drejtuar me gjysmë shpejtësi, të mos i jepet ndihmë mjekësore të ndjerit në moshën 16 vjeçare dhe t'i dorëzohen organet për më tej në procedurat e transplantimit. Në vijim tregohen zyrtarët dhe veprimet që ata kanë bërë/nuk kanë bërë, mbi të cilat parashtruesit i bazojnë pretendimet nga denoncimi.

Krahas aplikimit janë dorëzuar edhe dokumente që kanë të bëjnë me ngjarjen, pra një protokoll seksional, një kërkesë për pagesë për shpenzimet në lidhje me -----, një procesverbal nga kontrolli në vendngjarje dhe një skicë e inspektimit. Është dorëzuar edhe një mesazh elektronik në gjuhën angleze, me të cilin parashtruesi iu është drejtuar disa institucioneve dhe zyrtarëve vendas dhe të huaj, ndër të tjera edhe Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja ka konstatuar se në denoncim bëhet fjalë për pretendime të cilat nuk i nënshtrohen veprimit kompetent të KSHPK-së dhe kërkuesi iu drejtua organeve kompetente lidhur me veprimet e prokurorit publik dhe zyrtarëve policorë.

Nga aty KSHPK-ja konsideroi se nuk ka kompetencë të veprojë në rastin në fjalë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:

- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.K.SH

Miratoi : N.B anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHETETËROR PËR  
PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**

**Nënkryetar,  
Katica Nikolovska**